

KOLEGJI "BIZNESI"

Nr. 251-1/22 Dat. 31.06.2022
PRISHTINË



KOLEGJI - COLLEGE
BIZNESI
Prishtinë

*MANUAL PËR RISHIKIMIN,
NDRYSHIMIN DHE ZHVILLIMIN E
PROGRAMIT STUDIMOR*

2022

HYRJE

Qëllimi i këtij udhëzuesi është të ofrojë udhëzime të përgjithshme për stafin akademik kur fillon të zhvillojë ose të rishikojë kurrikulën. Dokumenti ofron një pasqyrë të procesit të rishikimit, ndryshimit ose zhvillimit të kurrikulës dhe sugjeron një sërë hapash që duhen ndjekur për krijimin e dokumenteve të kurrikulës.

Vështrim i përgjithshëm

Udhëzuesi për rishikimin, ndryshimin ose zhvillimin e kurrikulës paraqet një dokument të strukturuar që përshinë qëllimet, objektivat, përvojat mësimore, burimet mësimore dhe vlerësimet që do e përbëjnë programin studimor. Për më tepër, ai përfaqëson një artikullim të asaj që **studentët duhet të dinë dhe të jenë në gjendje të bëjnë** dhe i mbështet mësimdhënësit që të dinë se si t'i arrijnë këto qëllime.

Prandaj, udhëzuesi është një mjet që ndihmon në planifikimin dhe zbatimin e një programi studimor me cilësi të lartë. Kështu që ai:

- krijon një filozofi të qartë dhe një sërë synimesh gjithëpërfshirëse që drejtojnë të gjithë programin dhe vendimet që prekin çdo aspekt të programit;
- vendos sekuenca brenda dhe ndërmjet niveleve të studimit dhe siguron një progresion koherent dhe të artikuluar nga niveli në nivel;
- përshkruan kornizën bazë për atë që duhet bërë, si duhet bërë, kur duhet bërë dhe si të dihet nëse është arritur;
- lejon fleksibilitet dhe inkurajon eksperimentimin dhe inovacionin brenda një strukture të përgjithshme;
- promovon qasjet ndërdisiplinore dhe kur është e përshtatshme integrimin e kurrikulave;
- sugjeron metoda për vlerësimin e arritjes së qëllimeve dhe objektivave të programit;
- siguron një mjet për rishikimin dhe përmirësimin e tij të vazhdueshëm; dhe
- jep drejtim për prokurimin e burimeve njerëzore, materiale dhe financiare për zbatimin e programit studimor.

Formulimi i një udhëzuesi të këtillë për kurrikulat e institucionit nuk duhet të shihet si kulmi i procesit të zhvillimit të kurrikulës, por më tepër si një hap thelbësor në procesin e zhvillimit dhe zbatimit të kurrikulës në vazhdim. Prandaj, duhet parasysh faktin që asnjë udhëzues nuk do të jetë i përsosur dhe asnjë udhëzues nuk do të jetë kurrë një produkt i përfunduar dhe i gatshëm. Dhe gjithsesi, asnjë udhëzues nuk do të jetë i lirë nga kritikata. Megjithatë, për të qenë efektiv, një udhëzues duhet të pranohet nga mësimdhënësit dhe duhet të konsiderohet i vlefshëm nga pikëpamja arsimore nga komuniteti në përgjithësi i institucionit. Ky pranim do të jetë shumë më i lehtë për t'u arritur kur udhëzuesi i kurrikulës është:

- në përputhje me atë që dihet për zhvillimin e studentëve;
- në përputhje me filozofinë e përgjithshme të sistemit arsimor në vend;
- bazuar në bindje të qarta për mësimdhënien dhe të nxënit;
- përfaqësues i aktiviteteve mësimore për të plotësuar nevojat e studentëve me aftësi dhe nevoja të ndryshme;
- i lehtë për t'u përdorur nga të gjithë mësimdhënësit;
- mbushur me mostra, shembuj dhe burime të sugjeruara;
- zhvilluar në bashkëpunim nga një komitet me bazë të gjerë akademike dhe aktorësh të tjerë të interesuar; dhe
- i lidhur me qëllimet e vlerësimit të mësimdhënësve dhe zhvillimin profesional të tyre.

Gjenerimi i ideve të zhvillimit të programit të ri studimor

Në procesin e zhvillimit të programit të ri studimor (kurrikulës) ekziston afat kohor dhe zakonisht ky proces fillon me një ide, e cila mund të vijë nga burime të ndryshme, duke përfshirë, por pa u kufizuar vetëm në këto burime:

- Mësimdhënësit;
- Nevojat e tregut (Palët e interesuara/nevojat e industrisë, Raportet ekonomike, Tendencat e tregut bazuar në boshllëqet e identifikuar);
- Këshilli i Programit Studimor;
- Reagimet nga të diplomuarit dhe Alumni;
- Dokumentet strategjike të Kolegjit (Plani Strategjik) dhe ngjashëm.

Pavarësisht nga burimi i idesë për programin e ri, që zyrtarisht të fillojë procesi, Prodekani për arsim duhet ta dokumentoj idenë dhe ta paraqes në rend dite në Dekanat për diskutim dhe marrjen e vendimit në mbledhjen e tyre për propozim në KLMSH.

- a. Nëse miratohet propozimi, i dorëzohet Dekanit i cili e vendosën në rend dite në takimin e KLMSH për diskutim dhe miratim.
- b. Nëse nuk miratohet, PDA përgjegjës për paraqitjen do të shqyrtojë komentet e veprimit nga takimi i ekipit KLMSH, të cilat mund të përfshijnë ndërprerjen e idesë. Idetë mund të ndërpriten edhe për shkak të rreziqeve të mundshme të afektimit (ndikimit negativ) të programeve ekzistuese, kapacitetit të pamjaftueshëm të institucionit, mungesës së mbështetjes kapitale ose investimeve për të mbështetur idetë e reja që ecin përpara, potencialin e konkurrencës me programet ekzistuese.

Propozimi i programit studimor të ri **dorëzohet në Bordin drejtues për aprovim**. Propozimi fillimisht shqyrtohet nga Komiteti për çështje strategjike, arsimore dhe cilësi që është në kuadër të Bordit dhe Vendimi i Komitetit votohet dhe aprovohet ose jo në Bordin drejtues. Vendimi për

aprovimin/mosaprovimin nga Bordi miratohet si pikë në Rendin e ditës në KLMSH. Nëse është miratuar krijimi i programit të ri, atëherë **Komisioni për Rishikim, Ndryshim dhe Zhvillim të kurrikulës** fillon procesin e zhvillimit të Programit studimor të ri.

Procesi i zhvillimit të kurrikulës

Zhvillimi i një udhëzuesi të kurrikulës efektive është një proces me shumë hapa, i vazhdueshëm dhe ciklik. Procesi fillon me vlerësimin e programit ekzistues, pastaj, hartimin e një programi të përmirësuar, në zbatimin e një programi të ri dhe përsëri në vlerësimin e programit të rishikuar. Kolegji Biznesi e kryen këtë proces në mënyrë të planifikuar dhe sistematike që përfshin njëmbëdhjetë komponentët e renditur në Tabelën 1. Secili prej këtyre komponentëve trajtohet në seksionet në vijim.

Tabela 1: Komponentët e procesit efektiv të zhvillimit të kurrikulës

- A. Planifikimi:
 - 1. Mbledhja e Komisionit për Rishikimin, Ndryshimin dhe Zhvillimin Kurrikulës
 - 2. Identifikimi i çështjeve kryesore dhe tendencave në fushën specifike të përmbajtjes
 - 3. Vlerësimi i nevojave dhe çështjeve
- B. Artikulimi dhe zhvillimi:
 - 4. Artikulimi i Filozofisë së Programit
 - 5. Përcaktimi i qëllimeve të programit, në nivel të dhe lëndëve
 - 6. Zhvillimi dhe renditja e objektivave të nivelit të programit dhe lëndës
 - 7. Identifikimi i burimeve për të ndihmuar në zbatimin e programit
 - 8. Zhvillimi dhe/ose identifikimi i mjeteve dhe instrumenteve të vlerësimit për të matur përparimin e studentëve
- C. Zbatimi:
 - 9. Vënia në praktikë e Programit të Ri
- D. Vlerësimi:
 - 10. Përditësimi i Programit
 - 11. Përcaktimi i suksesit të programit

A. PLANIFIKIMI

1. Mbledhja e Komisionit për Rishikimin, Ndryshimin dhe Zhvillimin e Kurrikulës.

Komision që është forca shtytëse për ndryshimin e kurrikulës dhe procesit afatgjatë të zbatimit të kurrikulës kryesisht është i përbërë nga **mësimdhënës** që përfaqësojnë institucionin, **anëtarë të komunitetit të jashtëm dhe studentë**. Është shumë e rëndësishme që komisioni të drejtohet nga një kryetar efektiv, i ditur dhe i respektuar dhe ai të përfshijë anëtarë të ditur dhe të përkushtuar,

të cilët gradualisht de facto bëhen “ekspertë” gjatë fazave të zhvillimit dhe në fazat e zbatimit të procesit të zhvillimit të kurrikulës.

2. Identifikimi i çështjeve dhe tendencave kyçe në vend dhe jashtë vendit.

Hapi i parë në çdo proces të zhvillimit të kurrikulës përfshin analizën dhe kërkimin që shqyrton çështjet dhe tendencat e fundit të disiplinës, si në vend ashtu edhe jashtë vendit. Ky hulumtim ndihmon Komisionin për Rishikimin, Ndryshimin dhe Zhvillimin e Kurrikulës të identifikojë çështjet dhe tendencat kryesore që do të mbështesin vlerësimin e nevojave që duhet të përmbushen dhe filozofinë që duhet të zhvillohet.

Hulumtimi zakonisht duhet të filloj me leximin dhe diskutimin e komisionit të raporteve specifike thelbësore dhe përmbajtjes nga kurrikulat e kaluara. Anëtarët e komisionit duhet të shqyrtojnë atë që aktualisht mësohet në kurrikul. Ata duhet të shqyrtojnë standardet vendore dhe ndërkombëtare në këtë disiplinë. Anëtarët e komitetit duhet gjithashtu të pajisen me rezultatet e fundit të përcaktuara në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve të Kosovës dhe Kornizën Evropiane të Kualifikimeve dhe të jenë të njohur me materialet udhëzuese dhe vlerësimet që janë në përdorim gjatë gjithë programit. Përveç kësaj, komisioni duhet të njihet me materialet e reja mësimore të disponueshme – veçanërisht ato që mund të miratohen përfundimisht për të ndihmuar në zbatimin e kurrikulës së re. Anëtarët e komisionit duhet gjithashtu të zgjerojnë perspektivën e tyre dhe të mbledhin informacione duke vizituar sisteme të tjera arsimore në vend ose jashtë vendit që janë liderë të njohur në arsimin e lartë. Si rezultat i këtij procesi, anëtarët e komisionit duhet të identifikojnë shumë nga çështjet dhe tendencat e mëposhtme që do të duhet të adresohen gjatë kohës që procesi i zhvillimit të kurrikulës ecën përpara:

- plotësimi i nevojave të të gjithë studentëve;
- teoria e të nxënësve dhe gjetjet e tjera të psikologjisë njohëse (eng. *cognitive psychology*) se si studentët mësojnë;
- çfarë e përcakton gatishmërinë për zhvillim ose përshtatshmërinë për zhvillim;
- pritshmëritë aktuale në fushën përkatëse;
- njohuri dhe gatishmëri për ndryshim nga ana e mësimdhënësve;
- disponueshmëria e burimeve;
- roli dhe disponueshmëria e burimeve dhe teknologjisë të informacionit;
- çështjet e planifikimit;
- metodat dhe qëllimet e vlerësimit; dhe
- zhvillimi profesional.

3. Vlerësimi i nevojave dhe çështjeve.

Zhvillimin e kurrikulës duhet parë si një proces përmes të cilit plotësimi i nevojave të studentëve shpie në përmirësimin e të nxënësve të studentëve. Pavarësisht nga teoria apo modeli i ndjekur,

zhvilluesit e kurrikulës duhet të mbledhin sa më shumë informacione të jetë e mundur. Këto informacione duhet të përfshijë rezultatet ose pritshmëritë e dëshiruara të një programi me cilësi të lartë, rolin e vlerësimit, statusin aktual të arritjeve të studentëve dhe përmbajtjen aktuale të programit studimor. Informacioni duhet gjithashtu të marrë parasysh shqetësimet dhe qëndrimet e mësimitdhënësve, administratorëve, punëdhënësve dhe studentëve.

Analiza dhe vlefshmëria e burimeve të të dhënave siguron burime të ndryshme informacioni, të cilat do të bëjnë provat më të besueshme. Pra, cilët janë palët e interesuara që duhet të konsiderohen për të mbledhur informacionet?

- | | |
|--|--------------------------|
| 1. Studentët e diplomuar (të gjitha vitet) | 1. Punëdhënësit |
| 2. Asistentët mësimor | 2. Mësimitdhënësit |
| 3. Studentë të diplomuar | 3. Stafit administrativ |
| 4. Alumni | 4. Shoqatat Profesionale |
| 5. Kolegë nga programe të ngjashme | 5. Të tjerë |

Të dhënat duhet të përfshijnë mostra vlerësimesh, ligjëratat nga mësimitdhënësit, detyra, pikë në testet e standardizuara shtetërore, tekste shkollore që përdoren aktualisht, perceptimin e studentëve dhe reagimet nga punëdhënësit. Të pajisur me një grup të përbashkët kuptimesh që lindin nga identifikimi i çështjeve dhe tendencave, Komisionin për Rishikimin, Ndryshimin dhe Zhvillimin e Kurrikulës është në gjendje të kryejë një vlerësim të nevojave për të përcaktuar më mirë perceptimet, shqetësimet dhe dëshirat e secilës prej palëve të interesuara në proces. Duke i shqyrtuar me kujdes këto të dhëna, mund të zbulohen çështje kyçe që duhet të ndikojnë në hartimin e kurrikulës. Për shembull:

- mësimitdhënësit mund të jenë të pakënaqur me përmbajtjen dhe teknikat e vjetra në dritën e hulumtimeve të fundit;
- Rezultatet e provimeve mund të jenë në rënie ose më të ulëta se sa pritej në disa ose në të gjitha fushat përkatëse;
- mësimitdhënësit mund të mos kenë materiale ose mund të mos dinë të përdorin materiale për të përmirësuar të kuptuarit;
- mësimitdhënësit mund të dëshirojnë të përdorin më shumë teknologjinë për të përmirësuar mësim nxënien;
- mësimitdhënësit dhe të tjerët mund të dëshirojnë ta lidhin përmbajtjen e programit më afër me problemet dhe çështjet bashkëkohore;
- mësimitdhënësit mund të kërkojnë mënyra për të rritur sasinë e punës ndërdisiplinore në të cilën janë të angazhuar studentët;
- studentët mund të shprehin nevojat për mundësi të ndryshme dhe të pasuruara të kurrikulës;
- punëdhënësit dhe të tjerët mund të kenë shqetësime rreth zbatimit të kurrikulës.

Sido që të jenë rrethanat e veçanta, një proces efektiv i zhvillimit të kurrikulës zakonisht duhet të përfshi një vlerësim të strukturuar të nevojave për të mbledhur informacione dhe për të udhëhequr procesin e zhvillimit të kurrikulës. Informacionet e mbledhura zakonisht përmes sondazheve, diskutimeve të strukturuar dhe të dhënave të testimit, më së shpeshti përfshijnë:

- analiza të kurrikulës që ndihmojnë mësimdhënësit aktual që të identifikojnë pikat e forta, dobësitë, lëshimet dhe/ose problemet;
- shembuj të ligjëratave që ilustrojnë zbatimin e kurrikulës;
- shembuj të vlerësimeve që ilustrojnë zbatimin e kurrikulës;
- identifikimi i asaj që mësimdhënësit në çdo nivel të studimit i perceptojnë si çështjet më serioze brenda kurrikulës;
- analizë e detajuar e të dhënave të provimeve vendore dhe ndërkombëtare për nivele të studimit dhe rezultatet e provimit përfundimtar të lëndës;
- sugjerimet për ndryshim dhe përmirësim të krijuara nga takimet me mësimdhënësit, asistent demonstrator, tutor dhe administratorë; dhe
- shqetësimet dhe pritshmëritë e anëtarëve të tjerë të komunitetit për programin të grumbulluara nëpërmjet anketimeve dhe intervistave.

Të dhënat e mbledhura nga vlerësimi i nevojave së bashku me informacionet e marra nga hulumtimi dhe nga burime tjera të ndryshme bëhen baza mbi të cilën më pas ndërtohet e gjithë kurrikula e shkruar - nga përcaktimi i qëllimeve deri te vlerësimi.

B. ARTIKULIMI DHE ZHVILLIMI

4. Artikulimi i filozofisë të Programit studimor.

Pyetjet themelore që drejtojnë filozofinë gjithëpërfshirëse të programit studimor janë:

- Pse të mësosh (disiplinë specifike)?
- Mbi cilat parime udhëzuese është i ndërtuar programi studimor?
- Cilat janë besimet thelbësore rreth mësimdhënies dhe mësim nxënies në (disiplinë specifike)?
- Cilat janë pyetjet thelbësore?
- Si do të përdoret vlerësimi për të përmirësuar programin dhe mësimin e studentëve?

Si e tillë, filozofia e programit ofron një kornizë unifikuese që justifikon dhe i jep drejtim mësimin të bazuar në disiplinën përkatëse. Pasi të kenë studiuar tendencat e kurrikulës dhe të vlerësojnë programin aktual, zhvilluesit e kurrikulës duhet të jenë gati të ndërtojnë një draft filozofi që drejton programin studimor. Një filozofi e tillë ose grup besimesh duhet të jetë më shumë sesa thjesht

deklarimi “ajo që ne mendojmë se duhet të ndodhë”, por më tepër “ajo që kurrikula në të vërtetë po përpiqet të reflektojë”.

Deklarata efektive e filozofisë së programit përmban këto elemente:

1. Saktësia

- Filozofia përfaqëson pretendime që janë të mbështetshme.
- Filozofia thekson një rast arsimor të përshtatshëm për rolin e (disiplinës specifike) në kurrikulën dhe rëndësinë e saj në edukimin për të gjithë studentët.

2. Lidhjet

- Filozofia e programit është në përputhje me filozofinë e arsimit të vendit.
- Filozofia ofron një bazë të shëndoshë për qëllimet dhe objektivat e programit.
- Mësimdhënësit në vend janë të përkushtuar ndaj çdo besimi të përshkruar në filozofi.

3. Gjerësia dhe Thellësia

- Filozofia është në përputhje me praktikën e mira pedagogjike.
- Filozofia ofron një justifikim të qartë dhe bindës për programin studimor.

4. Dobia

- Filozofia është shkruar në gjuhë të qartë dhe të kuptueshme nga të gjithë palët e interesuara të institucionit.

5. Përcaktimi i qëllimeve të programit studimor, të nivelit të studimit dhe të lëndës.

Qëllimi i filozofisë së programit studimor është të përshkruajë atë çfarë besohet të arrihet dhe të informojë për procesin e mësimdhënies. Udhëzuesi i kurrikulës përcakton qëllimet e programit, qëllimet e nivelit të studimit dhe të lëndës që adresojnë pritshmëritë kryesore të përmbajtjes njohëse dhe efektive për programin.

Grupi efektiv i qëllimeve të programit ka karakteristikën e mëposhtme:


- Secili qëllim është konceptuar gjerësisht, për të siguruar zhvillim të vazhdueshëm të studentëve.
- Çdo qëllim del logjikisht jashtë filozofisë së disiplinës specifike dhe lidhja është e qartë.
- Çdo synim del nga një synim arsimor i vendit dhe lidhja është e qartë.
- Qëllimet janë mjaft gjithëpërfshirëse për të ofruar bazën për një program cilësor për të gjithë studentët në të gjitha vendet në vazhdimësinë e mësimin.
- Qëllimet përfshijnë secilin prej rezultateve të sugjeruara nga filozofia e programit studimor.
- Çdo qëllim është i realtë.
- Ekziston një numër i menaxhueshëm i synimeve (zakonisht ndërmjet 4-8).
- Çdo synim i lejon vetes zhvillimin e një ose më shumë objektivave.

6. Zhvillimi dhe renditja e objektivave në nivel të programit dhe lëndës.

Nëse filozofia dhe qëllimet e një kurrikule përfaqësojnë parimet drejtuese të kurrikulës, atëherë objektivat në nivel të programit dhe lëndës përfaqësojnë thelbin e kurrikulës. Objektivat specifike të nivelit të programit dhe të lëndës përfshijnë pritshmëri të qarta për atë që çdo student pritet të dijë dhe të jetë në gjendje të bëjë dhe si do të maten ato. Komisioni duhet të marrë në konsideratë disa pyetje kyçe për të identifikuar, përzgjedhur, shkruar dhe renditur objektivat:

- A është objektivi i matshëm dhe si do të matet ai?
- A është objektivi mjaft specifik për t'i dhënë lexuesit një kuptim të qartë të asaj që studentit duhet të jetë në gjendje të bëjë, duke mos qenë aq i detajuar sa ta bëjë deklaratën të mundimshme ose objektivin të parëndësishëm?
- A është objektivi i pajtueshëm me qëllimet dhe filozofinë e programit dhe nevojat reale dhe të reja të studentëve?
- A është objektivi real dhe i arritshëm nga studentët?
- A janë të disponueshme materialet dhe burimet e tjera të përshtatshme për ta bërë objektivin të arritshëm?

Përafrimi i rezultateve të programit dhe rezultateve të lëndës



Rezultatet e të nxënit të lëndës përshkruajnë njohuritë specifike të lëndës, aftësitë dhe shkathtësitë që një student duhet të jetë në gjendje të demonstrojë si rezultat i përvojës së tyre për lëndën. Në nivel programi, lëndët duhet të jenë organizuara për të formuar një kurrikul të integruar dhe

koherente bazuar në rezultatet e mësim nxënies të synuar të lëndës. Prandaj, çdo program studimor duhet të artikulojë se si programi i studimit adreson secilën prej pritjeve të nivelit të programit.

7. Shkrimi i rezultateve efektive të mësim nxënies dhe taksonomia e Bloom-it

Rezultatet e mësim nxënies janë pohime të drejtpërdrejta që përshkruajnë njohuritë, aftësitë dhe shkathtësitë që studentët pritet ti demonstrojnë me besueshmëri pas një përvoje mësimore. Përgjigja e pyetjeve të mëposhtme do të ndihmojë në identifikimin dhe përsosjen e rezultateve të të nxënies. Ky proces mund të përsëritet për të shqyrtuar si rezultatet e mësim nxënies të lëndës ashtu edhe rezultatet e mësim nxënies të programit, ndërsa duke pasur parasysh kornizën e rezultateve të mësim nxënies të Kolegjit dhe pritjet e nivelit studimor (sipaas KKK).

Rezultatet e mësim nxënies përshkruajnë të nxënies që është thelbësor dhe i qëndrueshëm; mësim nxënies që ka vërtet rëndësi afatgjatë dhe çfarë duhet të dinë studentët pasi të kenë harruar detajet e lëndës. **Mësim nxënies** mund të përshkruhet ose në kohën e ardhshme - që do të arrihet për një lëndë ose program të ri, ose në kohën e shkuar - të mësuarit që është arritur për proceset e akreditimit ose rishikimit akademik (Gosling & Moon, 2002).

Në shprehjen e tij më të thjeshtë, rezultati i mësim nxënies përbëhet nga një deklaratë e drejtpërdrejtë që shpesh fillon me:

"Studentët e suksesshëm do të jenë në gjendje" të cilës i shtohet një folje veprimi (*folje aktive*) që tregon nivelin e të mësuarit që synohet plus një deklaratë që ofron kontekstin disiplinor dhe identifikon atë që studentët do të jenë në gjendje të bëjnë si rezultat i ndryshimit. Kjo vlen edhe për rezultatet e mësim nxënies të lëndës dhe të programit, megjithëse rezultatet e mësim nxënies së lëndës janë më specifike.

6. Çfarë njohurish dhe aftësish dëshirojmë që studentët të demonstrojnë?
7. Si do të shpërndahen rezultatet e mësim nxënies me studentët?
8. Si do të kuptohet që studentët i kanë arritur këto rezultate?
9. Çfarë përvojash mësimore do të krijohen për t'i ndihmuar studentët të arrijnë këto rezultate?
10. Rezultatet e të nxënies duhet të jenë SMART:
 - a. **(S)** Specifike (të tregohet saktësisht se çfarë dëshirohet të arrihet (kush, çfarë, ku, pse)
 - b. **(M)** Të matshme (të demonstrohet dhe vlerësohet shkalla në të cilën është arritur qëllimi)
 - c. **(A)** Të arritshme (synime sfiduese dhe të shtrira brenda aftësive për të arritur rezultatet. Cila është folja e orientuar në veprim)
 - d. **(R)** Të përshtatshme (Si është i lidhur qëllimi me përgjegjësitë kryesore. Si përafrohet me objektivat)
 - e. **(T)** Të kufizuar me kohë (të përcaktohen një ose më shumë data të synuara, shprehja "deri kur" të drejtoj qëllimet drejt përfundimit të suksesshëm dhe në kohë (përfshini afatet, datat dhe frekuencat).

Taksonomia e Blumit. Brenda secilës prej fushave, Taksonomia¹ e Bloom-it e domenit njohës përshkruan një rend në rritje të niveleve e kompleksitetit në të menduarit dhe të mësuarit. Taksonomia është hierarkike dhe që studentët të arrijnë në fazat më të larta të rendit, së pari duhet të performojnë në nivelet më të ulëta. Për shembull, që studentët të aplikojnë njohurinë, së pari duhet ta kuptojnë atë. Diagrami i mësipërm ofron një listë të foljeve dhe veprimtarive të studentëve për të përshkruar të nxënit në nivele të ndryshme – kjo mund të jetë një paradigmë e dobishme në artikullimin e rezultateve të mësim nxënies. Secila prej taksonomive është shpjeguar më poshtë:

- **Të kujtoj (mbaj mend):** Studenti shfaq kujtesën e njohurive dhe materialit nëpërmjet aftësisë për të kujtuar dhe identifikon faktet dhe konceptet bazë.
- **Kuptimi:** Studenti shfaq aftësinë për të organizuar, përshkruar dhe shpjeguar një koncept duke përdorur fjalët e tyre.
- **Aplikimi:** Studenti mund të zbatojë njohuritë për zgjidhjen e problemeve dhe përshtatjen ndaj situatave të reja.
- **Analizimi:** Studenti shfaq aftësinë për të zbërthyer më tej njohuritë dhe të përdor prova për të mbështetur hipotezat.
- **Vlerësimi:** Studenti demonstroi aftësinë për të formuar opinione dhe të mbështes besimet e tij nëpërmjet të dhënave dhe analizave. Studenti gjithashtu mund të vlerësojë cilësinë, vlefshmërinë dhe saktësinë e informacionit.
- **Krijimi:** Studenti mund të përdorë njohuritë e tij për të sintetizuar informacione të reja dhe të mbindërtoj konceptet që i ka mësuar me qëllim që të krijoj një nivel më të thellë të njohurive.

8. Identifikimi i burimeve materiale për të ndihmuar zbatimin e programit.

Manuali efektiv i kurrikulës është shumë më tepër renditja e objektivave, por, identifikon burimet e sugjeruara për të ndihmuar në përgjigjen e pyetjes: "Çfarë materialesh janë në dispozicion për të ndihmuar të përmbushet një objektiv ose një grup objektivash të caktuar?" Pasi mësimdhënësit dhe programi studimor largohen nga qasja e një teksti të vetëm dhe përdorin një gamë më të gjerë materialesh plotësuese, module mësimore për njësi të veçanta, softuer kompjuterik dhe të ngjashme, është gjithnjë e më e rëndësishme që manuali i kurrikulës të sugjerojë dhe të lidhë burimet e disponueshme me objektivat e kurrikulës.

9. Zhvillimi dhe identifikimi i mjetve dhe instrumenteve të vlerësimit për matjen e progresit të studentëve.

Në shumë raste, kurrikulën si tërësi të bashkuar e mbajnë grupi i testeve të referuara në kritere të nivelit të programit, detyra të bazuara në performancë dhe provime përfundimtare të lëndës që i përgjigjen konkretisht pyetjes "Si do ta di mësimdhënësi që studentët e dinë dhe janë në gjendje të bëjnë atë që pritet prej tyre?" Kjo pjesë e procesit të zhvillimit të kurrikulës ndihmon në fokusimin

¹degë sistematike e shkencës që merret me klasifikimin

e mësimdhënies dhe siguron përafrimin shpeshherë të pakapshëm, por kritik të kurrikulës, instruksioneve dhe vlerësimit. Në thelb, pjesa e kurrikulës që ka të bëjë me vlerësimin është ajo që drejton kurrikulën. Vlerësimet matin jo vetëm përparimin e studentëve, por, edhe efektivitetin e qëllimeve dhe objektivave të kurrikulës në përmbushjen e nevojave të studentëve.

Grupi i testeve të referuara në kritere të nivelit të programit, detyrat e bazuara në performancë dhe provimet përfundimtare të lëndës duhet të krijohen së bashku me kurrikulën dhe të bëhen pjesë e vetë udhëzuesit të kurrikulës. Vlerësimet duhet të përfshijnë pritshmëri të qarta të performancës dhe një rubrikë që përcakton qartë pritshmëritë për studentët dhe mësimdhënësit. Ato ndihmojnë për të sqaruar saktësisht se çfarë nënkuptojnë objektivat e programit ose të lëndës dhe ofrojnë një standard të përbashkët për vlerësimin se sa me sukses janë arritur ato.

C. ZBATIMI

10. Vënia në praktikë e Programit të Ri.

Shumë shpesh, praktika tradicionale përfshin punën e Komisionit në shumë takime dhe diskutime deri në zbulimin dhe shpërndarjen e kurrikulës së përditësuar ose të rishikuar. Procesi i parashikuar këtu përfshin një qasje shumë më të thelluar dhe sistematike si për zhvillimin ashtu edhe për zbatimin e kurrikulës. Në vend që të supozohet se procesi përfundon me publikimin e një udhëzuesi të ri, Komisioni efektiv i kurrikulës vazhdon të mbikëqyrë zbatimin, përditësimin dhe vlerësimin e kurrikulës. Është e rëndësishme të mbahet mend se çdo risi e futur në sistem - duke përfshirë edhe kurrikulën e re - kërkon kohë dhe mbështetje për t'u zbatuar plotësisht. Së pari, mësimdhënësit kanë nevojë për kohë dhe mundësi për t'u **ndërgjegjësuar** për kurrikulën e re dhe dizajnin e saj të përgjithshme, veçanërisht nëse ajo ndryshon nga kurrikula e kaluar. Më pas mësimdhënësit kanë nevojë për kohë dhe mundësi për t'u **njohur** me kurrikulën e re – shpesh herë mbahen sesione në nivel të programit që fokusohen në ato pjesë specifike të kurrikulës për të cilat ato janë përgjegjës. Më pas, mësimdhënësve u duhen të paktën dy vjet që të **udhëheq** kurrikulën e re dhe materialet e reja në ligjeratat e tyre. Nuk është e pazakontë që kjo periudhë të zgjasë deri në dy vjet përpara se kurrikula e re të **zbatohet** plotësisht dhe të **integrohet** lehtësisht në praktikën e përditshme. Është thelbësore që Komisioni për rishikim, ndryshim dhe zhvillim të kurrikulës, mësimdhënësit dhe udhëheqësit të jenë të vetëdijshëm për këtë proces dhe të jenë në dispozicion për ta kultivuar atë.

D. VLERËSIMI

11. Përditësimi i Programit të Ri.

Në këtë kohë kur përpunimet të tekstit dhe të udhëzuesve të kurrikulës është më e lehtë se kurrë të përditësohen udhëzuesit dhe të mbahen ato si dokumente lehtë të ndryshueshme. Njëra nga metodat më të zakonshme për përditësimin periodik të udhëzuesit të kurrikulës është nëpërmjet takimeve të nivelit të programit studimor të krijuara për të ndarë materialet, aktivitetet, njësitë,

vlerësimet dhe madje edhe punën e studentëve që mbështesin arritjen e qëllimeve të kurrikulës që ishin të panjohura ose të padisponueshme kur udhëzuesi ishte i zhvilluar në fillim. Këto qasje janë mundësi të paçmueshme të zhvillimit profesional, kur mësimitdhënësit marrin përsipër pronësinë e kurrikulës për zbatimin e të cilës janë përgjegjës. Në këtë mënyrë, udhëzuesi bëhet një burim në rritje për zbatimin më efektiv të programit. Mësimitdhënësit janë veçanërisht mjet efektiv për përgatitjen dhe shpërndarjen e këtyre përditësimeve.

12. Përcaktimi i suksesit të programit të ri.

Cikli i zhvillimit të kurrikulës përfundon dhe më pas përsëri fillon me një vlerësim të kujdesshëm të efektivitetit dhe ndikimit të programit studimor. Duke përdorur sondazhe, diskutime të fokusuara dhe takime Komisioni për rishikim, ndryshim dhe zhvillim të kurrikulës duhet të mbledhë periodikisht të dhëna mbi perceptimet e pikave të forta, dobësive, nevojave, preferencave për tekstet shkollore dhe materiale të tjera dhe tema ose objektiva që nuk duket se janë duke punuar në mënyrë efektive. Ky informacion duhet të mblidhet nga të dhënat që përfaqësojnë performancën e përgjithshme të studentëve që janë të lidhura ngushtë me mësimin e përditshëm. Ekipet e mësimitdhënësve përgjegjës për disiplinat specifike mund ta arrijnë këtë duke ndarë mostra të vlerësimeve, detyrave të performancës, punës së studentëve, mësimëve dhe praktikave mësimore në lidhje me kurrikulën. Të dhënat nga këto sondazhe dhe takime duhet të kombinohen më pas me një analizë të kujdesshme të më shumë të dhënave numerike mbi programin si:

- Rezultatet e provimit dhe kritereve të lëndës;
- Vlerësimet që kanë zhvilluar mësimitdhënësit;

Ky rishikim dhe analizë e detajuar e informacionit sasior dhe cilësor mbi ndikimin e programit dhe mbi perceptimet për pikat e forta dhe të dobëta të tij përbën themelin për raundin tjetër të zhvillimit dhe përmirësimit të kurrikulës.

Prishtinë, 2022

